



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 17.5.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq,
Emilija Redzeqi, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.5.2016,
3. Shqyrtimi i raportit vjetor i ARRU,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 10.5.2016

Procesverbali nga data 10.5.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Autoritetit RRegullator për Ujëra

Kryesuesja përshëndeti dhe falënderoj për pjesëmarrje drejtorin e Autoritetit rregullator për ujëra **Raif Pretenin** të cilit i uroj punë të suksesshme edhe në mandatin e dytë, ndërsa drejtori falënderoi për mundësinë e raportimit dhe potencoi se ky raportim është i shtati me radhë për kuvendin e cila sikurse tjerat është i përcjellur me sfida të shumta. Kompanive, vazhdoi, ju ka skaduar licenca për shërbime si pasojë e vonësës së procedurës së emërimit, kurse tani është procedura e licencimit të tyre. Monitorimi i kompanive tha ai ka qenë objektiv i punës së autoritetit për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve duke siguruar transparencën e punës së tyre si dhe për të stimuluar konkurrencën mes kompanive me qëllim të përmirësimit të kualitetit të shërbimeve. Fillimisht është përcaktuar tarifa për aplikim për 2015 me të drejtë rishikimi të rregullt dhe të jashtëzakonshme. Bazat e rishikimit të tarifave për faturim të konsumatorëve janë shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me proces rregullator të tarifave, shkalla e realizimit të investimeve kapitale gjatë periudhës së shkuar për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi, lëvizjet inflatore dhe gjendja socio ekonomike në vend.

Kryesuesja pyeti drejtorin për dorëheqjen e Sabrije Abazit-kryesuese e komisionit shqyrtues dhe për problemet aktuale me të cilat ballafaqohet ky autoritet, **Adem Salihaj** pyeti për shkaqet e mosarkëtimit sipas planit vjetor dhe cilat kompani nuk kanë kryer detyrat e veta, gjithashtu bëri vërejtje për rekomandime në raportim ngase rekomandime nxjerr komisioni jo ky autoritet. Lidhur me pyetjen për Sabrije Abazin drejtori tha se të njëjtën e ka njoftuar që të paraqes dorëheqjen në Kuvend ngase është e emëruar aty por sugjerimi i tij gjithmonë ka qenë që Komisioni për buxhet të përcaktojë pagën ngase buxheti në autoritet është i ndarë për atë vend pune, përndryshe askush nuk punon në një vend pune ku nuk ka punë përkatësisht ka mbledhje të rralla ku pagesa bëhet me mëditje, do të thotë varet prej ankesave sa ka punë ky vend i punës. Ai vazhdoi me përgjigje dhe tha se humbjet e ujit janë të mëdha 56% kurse si zakonisht shkaqet janë shumë, vjedhja e ujit, keqpërdorimet, humbjet teknike etj, këtë gjendje shkaktajnë arkëtimi i pamjaftueshëm, skadimi i licencave, vonesa e pajisjes me leje ujore nga MMPH. Lidhur me rekomandime drejtori potencoi faktin se ish komisioni parlamentar ka obliguar këtë autoritet të rekomandoj ndaj ky organ si hartim adekuat të raportimit ka përdor rekomandimet që nuk do të thotë se ato duhet të miratoj ky komision. **Emilija Redzepi** pyeti për shkaqet e mospërfshirjes së rajonit të Zhupës në sistemin e ujësjellësit dhe a do të paguajnë këta banorë sikurse tjerët në Kosovë, gjithashtu pyeti për procedurën e dhënies së lejeve për hidrocentrale a ka pasur shkelje ngase nuk janë zhvilluar debate me qytetarët. Drejtori u përgjigj se do të përkujdeset për rajonin e Zhupës të jap informata

ngase emërimi për drejtor është vonuar dhe nuk është në rjedha kurse për hidrocentrale nuk është kompetencë e autoritetit por edhe për këtë çështje do të konsultohet për të informuar. **Adem Salihaj** u bashkëngjiti me konstatim shtesë se nuk është e mundur humbjet e ujit 56% të shkaktohen vetëm nga inventarizimi i vjetërsuar, por ky autoritet duhet të kontrolloj edhe vendet ku ndërtohen ndërtesat e reja si furnizohen ndërtuesit të cilët pa kontrollë shfrytëzojnë ujin, shumë ndërtesa nuk kanë ujëmatëse, autolarjet përkundër kamuflimit kinse kanë një bunar ato shfrytëzojnë ujin e ujësjellësit etj dhe shtoi se autoriteti duhet të krijoj mekanizma më të larta për disiplinim të mëtejshëm ngase normal është që nuk mundemi të presim ulje të shpejt të cifrës 56, përmendi shembullin e Ferizajit në aspektin pozitiv dhe përsëriti dëmet që bëhen nga gypat e vjetruara ku jo vetëm që uji shkon poshtë por edhe shkatërrohen rrugët si pasojë e rrjedhjes së ujit dhe shembjes së dheut ndër asfalt. Ai kërkoi angazhime nëse ka mundësi edhe më të larta ngase nëpër vende të ndryshme janë edhe detektorët që tregojnë ku ka rrjedhje uji dhe të bëhen kërcënime publike për marrjen e licencave, alarmime të humbjeve etj Drejtori potencoi se për të gjitha këto gjëra që bëhen, autoriteti ka vetëm një mundësi të luftimit të tyre , kjo është përmes tarifave, kompanitë duhet më tepër të janë syqeltë dhe të shkarkojnë udhëheqësit e papërgjegjshëm, ndërsa në pyetjen e **Duda Balje** rreth kushtëzimit të regjistrimit të automjetit me faturë uji, tha se tanimë ajo nuk ekziston por megjithëkëtë ky autoritet nuk ka të bëjë me këtë ngase këtë kushtëzim e kanë aplikua organet komunale, kurse për donacionet e Zvicrës dhe përgjithësi për ato drejtori tha se nuk kontrollohen nga ky autoritet. Gjithashtu edhe **Murat Hoxha** shprehu brengosjen për humbjet që shkaktohen si pasojë e vjetërsimit të gypave dhe pyeti sa mundet autoriteti në këtë drejtim me ndikua pozitivisht dhe a ka ndonjë plan menaxhimi më të mirë për të zvogëluar këtë përqindje brengosëse të humbjeve. Përgjigja nga drejtori ishte ngjashëm sikurse për parafolësit tjerë dhe shtoi se autoriteti ka drejt të revokoi licencat, por kompanitë janë ata që duhet të zvogëlojnë humbjet dhe mos të lejohen paga të dyfishta. Lidhur me trajtimin e ujërave të zeza theksoi se gjendja është ajo që ende dominon kaheërë, ngase nuk ka investime të reja përveç impiantit në Skenderaj. **Sami Hasani** drejtor departamentit të tarifave në ARRU detalisht sqaroi gjendjen e infrastrukturës duke potencuar se rrjeti ka mjaft dëmtime, mirëpo megjithatë është funksional, sidomos kualiteti i ujit është i kënaqshëm. **Shaip Muja** theksoi se komisioni nuk duhet të analizoi gjërat tepër teknike por fokusimi duhet të jetë performanca e bordeve që caktohen nga qeveria, siç është bordi i Batllavës ku duhet bërë shkarkime ngase dikush duhet të paguaj faturën e ujit dhe përmirësimin e kualitetit të ujit, ndërsa për dorëheqjen e ofruar nga Kryesuesja e komisionit shqyrtues në ARRU **Sabrije Abazi** sugjeroi që komisioni mos ta miratoi dhe të njoftoi atë se mundet të mbetet në këtë funksion dhe të punoi edhe në ndonjë vend tjetër. Komisioni në vazhdim diskutoi për modalitetet se si do të duhej të paguhet ky vend i punës, por pa ndonjë vendim konkret.

Komisioni rekomandoi miratimin e raportit në mbledhjen plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje